Gratë në Kosovë vazhdojnë të jenë të pabarabarta me burrat për sa i përket pronësisë, si personale ashtu edhe tregtare. Në vitin 2017, vetëm 17% e të gjitha pronave në Kosovë ishin në pronësi të grave.⁵⁷ Kjo është një përqindje tepër e ulët, edhe kur merret parasysh se kjo në të vërtetë shënon një rritje nga viti 2016, kur gratë zotëronin vetëm 14% të të gjitha pronave. Hulumtimet tregojnë se shumë qytetarë ende besojnë se gratë nuk duhet të trashëgojnë pronë nga familjet e tyre të lindjes. Një total prej 35% e të anketuarve të një studimi besuan se gratë nuk duhet të trashëgojnë pronë, përfshirë 38% të grave dhe 44.6% të burrave.⁵⁸ Pronësia tregtare është gjithashtu një problem për gratë në Kosovë. Të dhënat nga viti 2017 tregojnë se gratë zotërojnë vetëm 13% të ndërmarrjeve në Kosovë dhe se ndërmarrjet e drejtuara nga gratë marrin vetëm 17% të subvencioneve nga Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë.⁵⁹ Për më tepër, vetëm 15% e grave pronare të bizneseve kanë përdorur më parë kredi bankash për biznese në Kosovë.⁶⁰ Ky problem përkeqësohet më tej nga pronësia e ulët e grave në pronë, gjë që e bën më të vështirë marrjen e kredive bankare. Kjo mungesë e pronësisë tregtare është e dukshme edhe në sektorin e bujqësisë, ku gratë zënë vetëm 4.9% të të gjithë pronarëve të tokave bujqësore.⁶¹

54 Qosaj-Mustafa dhe Morina, "Qasja në drejtësi për viktimat e dhunës me bazë gjinore: Përfundimi i mosndëshkimit të autorëve të krimit,

55 Intervistë me zyrtarin e MASH, prill 2020.

56 Qeveria e Kosovës, Rregullorja Nr. 21/2013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-universitar, 2013, në: [kryeministri-ks.net/repository/docs/RREGULLORE_QRK-NR_21_2013_PER_PROTOKOLLIN_PER_PARANDALIMIN_DHE_REFERIM...pdf](https://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/RREGULLORE_QRK-NR_21_2013_PER_PROTOKOLLIN_PER_PARANDALIMIN_DHE_REFERIM...pdf)

57 Rrjeti i Grave të Kosovës, Analiza Gjinore e Kosovës, faqe 16, 2018

58 Programi i të Drejtave Pronësore (PRP), Studimi bazë në nivelin nacional mbi të drejtat pronësore në Kosovë, 2015, në: <https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1863/1.%20National%20Baseline%20Survey%20for%20Property%20Rights%20in%20Kosovo.pdf>

59 Rrjeti i Grave të Kosovës, Analiza gjinore, faqe 41, 2018

60 Po aty.

61 Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat, Gra të forta dhe me vizion - Gratë rurale në Kosovë krijojnë vende pune dhe jetesë më të mirë, 2019, në: <https://ppse-kosovo.org/women-of-resilience-and-vision-rural-women-in-kosovo-creating-jobs-and-better-lives/>

Analiza gjinore e arsimit parauniversitar

Analiza gjinore e nxënësve në arsimin parauniversitar

Niveli shkollor	Djem	Vajza	Gjithsej
Parashkollor (0<5)	53.8%	46.2%	4117
Parafillor (5-6)	51.8%	48.1%	22.051
Fillor dhe i mesëm i ulët	51.4%	48.6%	235.161
I mesëm i lartë	50.8%	49.2%	81.041

Sipas Regjistrimit të Popullsisë më të fundit të bërë në Kosovë në vitin 2011, 1.739.825 qytetarë banojnë në Kosovë, 50.34% e të cilëve janë burra dhe 49.65% gra.⁶² Ky ndryshim është i ngjashëm në të gjitha grupmoshat, përfshirë grupmoshat e nxënësve të arsimit parauniversitar. Në përgjithësi, vajzat dhe djemtë janë relativisht proporcionalisht të përfaqësuar në arsimin parauniversitar. Në vitin shkollor 2018-2019, 51.3% e të gjithë nxënësve ishin djem, dhe 48.6% ishin vajza.⁶³ Megjithatë ekzistojnë disa dallime sipas nivelit të arsimit. Vajzat janë të nënpërfaqësuar në edukimin parashkollor në tërë Kosovën, me vetëm 46.2% të nxënësve parashkollorë duke qenë vajza. (Tabela 1).⁶⁴ Ky nënpërfaqësim i vajzave në edukimin parashkollor mund t'i atribuohet disa faktorëve, duke përfshirë institucione të pamjaftueshme të përballeshme parashkollorë, të kuptuarit e dobët të rëndësisë së qëndrimeve gjinore parashkollorë dhe stereotipe,⁶⁵ etj. Sidoqoftë, ekzistojnë dallime ndërmjet komunave me disa komuna që kanë një numër pothuajse të barabartë të vajzave dhe djemve në edukimin parashkollor (Komuna e Fushë Kosovës me 69 djem dhe 62 vajza), disa kanë më shumë vajza sesa djem (komuna e Pejës me 98 djem dhe 109 vajza); dhe shumica kanë një numër shumë më të madh të djemve sesa vajzave (për shembull, Komuna e Vushtrrisë me 70 djem dhe 29 vajza që vijojnë edukimin parashkollor).⁶⁶ Nga ana tjetër, kur bëhet fjalë për arsimin parafillor, vajzat dhe djemtë përfaqësohen mjaft proporcionalisht (Shih Tabelën 1). Vajzat dhe djemtë gjithashtu përfaqësohen

“Me klasa të mbipopulluara dhe me pak institucione parashkollorë të përballeshme, familjet (veçanërisht familjet e varfra) shpesh ballafaqohen me vendimin se cilin fëmijë ta dërgojë në parashkollor. Për shkak të stereotipeve gjinore ata më shpesh zgjedhin djemtë e tyre”

Ekspert për arsim parauniversitar

“Mungesa e orientimit cilësor në karrierë ka bërë që nxënësit të marrin vendime për karrierë bazuar në stereotipe gjinore”

Ekspert për arsim parauniversitar

62 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Platforma ASKData, “Popullsia sipas Gjinisë në Kosovë, 2011”, në: https://askdata.rks-gov.net/PXWeb/px-web/en/askdata/askdata__09%20Population__Population%20Structure/Population%20by%20sex%20and%20years%201921-2011%20in%20Kosovo.px/table/tableViewLayout1/?rxid=6c75a9aa-627c-48c6-ae74-9e1b95a9c47d


63 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, “Statistikat e Arsimit në Kosovë”, 2018-2019, në: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/08/education-statistics-2018-2019.pdf>

64 Po aty.

65 Rrjeti i Grave të Kosovës, Analiza Gjinore e Kosovës, 2018 dhe Intervista me ekspertin e arsimit parauniversitar, prill 2020.

66 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, “Statistikat e Arsimit në Kosovë”, 2018-2019,

proporcionalisht në arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë. Sidoqoftë, përderisa përfaqësimi i përgjithshëm i vajzave dhe djemve është proporcional në arsimin e mesëm të lartë, ai ndryshon në mënyrë thelbësore kur analizohet siç zërthehet sipas llojit të institucionit (Grafiku 1).⁶⁷ Vajzat janë kryesisht të nënpërfaqësuar në shkollat profesionale (41%) dhe djemtë janë të nënpërfaqësuar në gjimnaze (41.6%). Ky ndryshim i madh mund



t'i atribuohet disa faktorëve, duke përfshirë suksesin më të lartë akademik të vajzave në arsimin fillor dhe të mesëm të lartë, mungesën e orientimit⁶⁸ institucional në karrierë, por edhe stereotipet gjinore të përhapura dhe rolet tradicionale gjinore.⁶⁹ Vajzat shpesh mund të besojnë se nuk janë të përshtatshme për profesione të caktuara dhe vetëm përpiqen të regjistrohen në gjimnaze.⁷⁰ Në fakt, provat globale sugjerojnë se tregjet e punës janë thellësisht të zërthyera sipas gjinisë.⁷¹ Hulumtimet e fundit në Kosovë kanë zbuluar se zgjedhjet arsimore në të vërtetë bëhen bazuar në pikëpamjet stereotipike mbi atë që përbën profesione më të përshtatshme për gratë kundrejt atyre për burra.⁷² Vajzat kanë preferuar profesione të tilla si psikologjia, edukimi dhe mjekësia që kërkojnë më pak shkathtësi matematikore (pavarësisht se kanë nota më të mira në të gjitha lëndët) dhe kanë të bëjnë me "ndihmën ndaj të tjerëve". Djemtë, nga ana tjetër, kanë preferuar profesione që perceptohen se kërkojnë më shumë tipare "mashkullore" si bujqësia, shkencat kompjuterike dhe edukata fizike.⁷³ Mungesa e përgjithshme e një studimi të thelluar për ato profesione që do të na duhen në të ardhmen po sjell dëm serioz në orientimin në karrierë si për vajzat ashtu edhe për djemtë.⁷⁴

Një analizë e ndjeshme gjinore e asaj se çfarë karrierash/profesione do të nevojiten në të ardhmen mund të ndihmojë në hartimin e planeve të orientimit në karrierë për nxënësit dhe të minimizojë stereotipet gjinore në përzgjedhjen e karrierës.

Normat e braktisjes në arsimin parauniversitar

Të dhënat e zërthyera sipas gjinisë për norma të braktisjes së shkollës nuk janë rregullisht dhe publikisht të disponueshme nga MASH. Këto të dhëna duhet të kërkojnë manualisht nga stafi i MASH, gjë që çon në nivele më të ulëta të transparencës. Normat e braktisjes për nxënësit në shkollën fillore dhe të mesme të ulët janë mjaft e ulëta. Për shembull, në vitin akademik 2017/2018 vetëm 0.09% e nxënësve kishin braktisur, dhe vetëm 0.07% e nxënësve kishin braktisur në vitin akademik 2018/2019.⁷⁵

67 Po aty.

68 Intervista me ekspertin e arsimit parauniversitar, zyrtarët e MASH-t dhe OSHC-të që punojnë me fëmijë të cenueshëm

69 Po aty. Shih: Shelley Correll, Gjinia dhe Procesi i Zgjedhjes së Karrierës: Roli i Vetë-vlerësimeve, 2001, Chicago Journals, në: https://sociology.stanford.edu/sites/g/files/sbiybj9501/f/publications/gender_and_the_career_choice_process_the_role_of_biased_self-assessments.pdf dhe Qendra për Gjininë në Organizata, Dreaming Big: Çfarë ka gjinia të bëjë me të? Ndikimi i stereotipeve gjinore në aspiratat e karrierës së shkollarëve të arsimit të mesëm, 2012, në: <https://www.simmons.edu/sites/default/files/2019-03/Insights%2035.pdf>

70 Intervistë me ekspertin e arsimit parauniversitar

71 Komisioni Evropian, "Një metodë e re për të kuptuar ndarjen gjinore në profesione në tregjet evropiane të punës, 2015, në: <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/2f6938c9-86ac-11e5-b8b7-01aa75ed71a1/language-en>

72 Qendra për Studime Sociale dhe Zhvillim të Qëndrueshëm, Stereotipet Gjinore dhe Zgjedhjet në Karrierë në Kosovë, 2019, në: helvetas-ks.org/eye/file/repository/LEAP_projekti_eng_print_v1_3_.pdf


73 Po aty.

74 Po aty.

75 Të dhënat e paraqitura nga MASH për qëllimet e këtij studimi, prill 2020.


Sidoqoftë, në përgjithësi, më shumë djem sesa vajza e braktisin shkollën fillore dhe të mesme të ulët në Kosovë. Në vitin 2018. 57.9% e të gjithë nxënësve që braktisën ishin djem, dhe në vitin 2019 63.5% e të gjithë nxënësve që braktisën ishin djem. Shkolla e mesme e lartë sheh nivele shumë më të larta të braktisjes. Për shembull, në vitin akademik 2018/2019, një pjesë shumë më e lartë e djemve braktisin shkollimin e detyrueshëm. Që nga viti akademik

Grafiku 2. Normat e braktisjes së shkollës fillore dhe të mesme të ulët 2012/2013-2018/2019



2013/2014, mbi 70% e të gjithë nxënësve që kanë braktisur çdo vit arsimin e mesëm të lartë kanë qenë djem. Diferenca midis djemve dhe vajzave po rritet çdo vit me një diferencë gjithnjë e më të lartë të shënuar në vitin akademik 2018/2019 ku 78.7% e të gjithë nxënësve që braktisën ishin djem. Provat nga e gjithë bota tregojnë se arsyet e braktisjes ndryshojnë midis djemve në krahasim me vajzat.⁷⁶ Në disa vende, vajzat janë vërejtur të braktisin shkollën për shkak të aktiviteteve pa pagesë të kujdesit dhe punëve të shtëpisë.⁷⁷ Djemtë, nga ana tjetër, janë vërejtur të braktisin për shkak të stereotipit gjinor ndaj djemve në mjediset e performancës dhe synimit për punë.⁷⁸ Fatkeqësisht, asnjë analizë e tillë nuk është kryer në Kosovë, por hulumtimet e mëparshme kanë spekuluar se vajzat dhe djemtë mund të braktisin shkollimin e detyrueshëm për arsye të ndryshme.⁷⁹ Duke u bazuar në përvojën e tyre si ekspertë dhe praktikues, të intervistuarit theksuan se kjo është e vërtetë edhe në Kosovë. Të rinjtë mund të braktisin shkollën në norma më të larta për arsye ekonomike dhe financiare, përfshirë kërkimin e punës.⁸⁰ Nga ana tjetër, të rejtat mund të braktisin shkollën për shkak të çështjeve që lidhen me mentalitetin, si dhe të fejesave ose martesave të hershme.⁸¹ Megjithatë, kjo bazohet në përvojën dhe ekspertizën e ekspertëve dhe praktikuesve. Hulumtimi i mëtutjeshëm sasior dhe cilësor është thelbësor për të ekzaminuar arsyet potencialisht të ndryshme se pse vajzat dhe djemtë e braktisin shkollën dhe për të hartuar politika parandaluese, të ndjeshme ndaj gjinisë.

Grafiku 3. Normat e braktisjes së arsimit të mesëm të lartë 2012/2013 - 2018-2019



76 Ingvid Almas Alexander et al. Çfarë shpjegon hendeku gjinor në normë të lartë të braktisjes së shkollës? Provat eksperimentale dhe administrative, 2015, dhe Victor Lavy, A i zvogëlojnë stereotipet gjinore arrijtjet e kapitalit njerëzor të vajzave apo djemve? Dëshmi nga një eksperiment natyror, Revista e Ekonomisë Publike, 2008, në: <https://www.sciencedirect.com/science/article/abs/pii/S0047272708000418>

77 Shih për shembull Jennifer Rothchild, "Edukimi i Krijuesve të Problemeve Gjinore dhe Fuqizimi në Nepal", faqe 92, 2007, Raporti i shtypur dhe kollokuimi kombëtar, "Trajnimi për shkathtësi profesionale dhe jetësore të vajzave adoleshente jashtë shkollës në grupmoshën 15-18, 2015, <https://ncpcr.gov.in/showfile.php?lang=1&level=1&&sublinkid=1357&lid=1558>, dhe SIDA, Perspektivat gjinore mbi shkaqet dhe efektet e braktisjes së shkollës, 2016, në: www.ungei.org/Final_Paper_on_Gender_perspectives_C2.pdf

78 Shih Victor Lavy, A i zvogëlojnë stereotipet gjinore arrijtjet e kapitalit njerëzor të vajzave apo djemve? Dëshmi nga një eksperiment natyror, Revista e Ekonomisë Publike, 2008, dhe Alabdulrazaq et al, Përcaktuesit e braktisjes së shkollës së mesme midis djemve në provincën Riyadh të Arabisë Saudite, 2019,

79 Morina dhe Farnsworth, Buxhetimi drejt një arsimimi më të mirë, 2015

80 Intervistë me zyrtarin e MASH dhe ekspertin e arsimit parauniversitar, prill 2020

81 Po aty.

Analiza gjinore e mësimdhënësve në arsimin parauniversitar

Tabela 2. Mësimdhënësit në arsimin parauniversitar, 2018-2019

Parashkollor			Para-fillor, fillor dhe të mesme të ulët			I mesëm i lartë		
Burra	Gra	Gjithsej	Burra	Gra	Gjithsej	Burra	Gra	Gjithsej
0	100%	548	42.5%	57.5%	17.404	58.5%	41.5%	5.261

Burrat janë të nënpërfaqësuar si mësimdhënës në nivele më të ulëta të arsimit, ndërsa gratë janë të nënpërfaqësuar në nivele më të larta të arsimit. Gjatë vitit akademik 2018-2019, por edhe viteve të mëparshme, sa më i lartë të jetë niveli i arsimit, aq më e ulët është përqindja e grave mësimdhënëse. Konkretisht, në 2018-2019, 100% e të gjithë mësimdhënësve në edukimin parashkollor ishin gra, 57.5% e të gjithë mësimdhënësve në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm të ulët ishin gra, dhe 41.5% e mësimdhënësve në shkollën e mesme të lartë ishin gra.⁸²

Siç u përmend më lart, zgjedhjet arsimore në Kosovë bëhen bazuar në pikëpamjet stereotipike gjinore.⁸³ Kjo përfshin vajzat që zgjedhin profesione të lidhura në mënyrë stereotipike “tipare femërore” dhe të orientuara drejt “ndihmës ndaj të tjerëve”⁸⁴, me djemtë që zgjedhin profesione në mënyrë stereotipike “mashkullore” siç përkruhet më sipër.⁸⁵ Këto stereotipa janë një faktor i madh se pse disa burra studiojnë edukim dhe janë të përfshirë si edukatorë. Këto stereotipa mund t’i pengojnë burrat nga studimi i mësimdhënies parauniversitare në radhë të parë, si dhe nga hyrja në profesion.⁸⁶ Sidoqoftë, kjo paraqet një problem serioz, pasi vazhdon të forcojë perceptimin tradicional të asaj që përbën profesione të përshtatshme për burrat (profesor, mësimdhënës të shkollës së mesme të lartë), dhe për një grua (kujdestare, mësimdhënie të edukimit parashkollor).⁸⁷

Tabela 3. Staf Administrativ dhe Mbështetës, 2018-2019

Staf administrativ								
Parashkollor			Fillor dhe i mesëm i ulët			I mesëm i lartë		
Burra	Gra	Gjithsej	Burra	Gra	Gjithsej	Burra	Gra	Gjithsej
17%	83%	100	72.48%	27.51%	1225	76%	24%	350
Staf mbështetës								
Parashkollor			Fillor dhe i mesëm i ulët			I mesëm i lartë		
Burra	Gra	Gjithsej	Burra	Gra	Gjithsej	Burra	Gra	Gjithsej
36.9%	63.1%	206	88.4%	11.6%	2467	86.9%	13.1%	521

82 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, “Statistikat e Arsimit në Kosovë”, 2018-2019,

83 Qendra për Studime Sociale dhe Zhvillim të Qëndrueshëm, Stereotipet Gjinore dhe Zgjedhjet në Karrierë në Kosovë, 2019,

84 Po aty.

85 Po aty.

86 Rrjeti i Grave të Kosovës, Analiza Gjinore e Kosovës, 2018

87 Rrjeti i Grave të Kosovës, Analiza Gjinore e Kosovës, 2018 dhe Intervista me ekspertin e arsimit parauniversitar, prill 2020

Gratë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar si staf administrativ dhe mbështetës në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, përveç edukimit parashkollor. Ndërsa gratë përbëjnë 83% të stafit administrativ parashkollor, ato përbëjnë 28.5% të stafit administrativ fillor dhe të mesëm të ulët, dhe 24% të stafit administrativ të mesëm të lartë. Ngjashëm, ato përbëjnë 63.1% të stafit mbështetës parashkollor, krahasuar me vetëm 11.6% të stafit mbështetës fillor dhe të mesëm të ulët, dhe 13.1% të stafit mbështetës të mesëm të lartë.⁸⁸

Analiza gjinore e sektorit të arsimit: Nevojat e Veçanta Arsimore

Siç theksohet më lart, personat me nevoja të veçanta gjithashtu përbëjnë një grup shumë të cenueshëm që përballet me disa pabarazi ndërthurre. Shumë persona me nevoja të veçanta kryesisht mbështeten në familjen e tyre për ndihmë ditore dhe mbështetje financiare.⁸⁹ Të dhënat konfirmojnë se rreth 33% e grave me nevoja të veçanta dhe 23% e burrave nuk janë regjistruar kurrë në shkollë.⁹⁰ Për ata fëmijë që vijnë arsimin, infrastruktura e pamjaftueshme, mungesa e asistentëve personal dhe mungesa e materialit të duhur mësimor vazhdojnë të minojnë pjesëmarrjen e tyre të suksesshme në arsim.⁹¹ Fëmijët me NVA vazhdojnë të përballen me stigmatizim dhe paragjykim nga bashkëmoshatarët e tyre për shkak të nevojave të tyre.⁹²

“Stigmatizimi i personave me NVA është i përhapur në Kosovë. Djemtë dhe vajzat me NVA vazhdojnë të përballen me stigmatizim dhe paragjykim nga bashkëmoshatarët e tyre”

OSHC-të që punojnë me persona me nevoja të veçanta

Tabela 4. Personat me nevoja të veçanta që jetojnë në Kosovë, sipas llojit të aftësisë së kufizuar						
Lloji i aftësive të kufizuara	Shurdhësia ose dëmtimi i rëndë i dëgjimit	Verbësia ose dëmtimi i rëndë i shikimit	Paaftësia themelore fizike	Paaftësia në mësimnxënie ose intelektuale	Vështirësia e gjatë psikologjike ose emocionale	Tjetër
Gjithsej	9935	9435	31567	5607	8133	28611
Burra	53%	49%	46%	47%	52%	42%
Gra	47%	51%	54%	53%	48%	58%

Të dhënat e regjistrimit të popullsisë tregojnë se në përgjithësi, ka më shumë gra dhe vajza me nevoja të veçanta që jetojnë në Kosovë. Nga 93.288 persona me nevoja të veçanta, 55.3% ishin gra dhe 46.5% ishin burra. Kishte ndryshime sipas llojit të nevojës së veçantë, me më shumë burra që kishin shurdhim ose dëmtim të rëndë të dëgjimit dhe një vështirësi e gjatë psikologjike ose emocionale në krahasim me gratë. Sidoqoftë, më shumë gra kishin verbëri ose dëmtim të rëndë të shikimit, paaftësi themelore fizike, paaftësi në mësimnxënie ose intelektuale, dhe të tjera (Shih tabelën 4).

⁸⁸ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, “Statistikat e Arsimit në Kosovë”, 2018-2019,

⁸⁹ Ambasada e Suedisë në Prishtinë, Analiza shumëdimensionale e varfërisë, 2017

⁹⁰ Po aty


⁹¹ Farnsworth, Morina, dhe Nuhio, “Vlerësimi gjinor, LGBTI-së dhe i personave me aftësi të kufizuara”, 2018, në: <https://www.edu-links.org/sites/default/files/media/file/Gender-LGBTIPWD%20assessment%20Kosovo%202018.pdf>

⁹² Këshilli Rinor Kosovar, “Mos Supozo Nevojat e Mia” - Mos supozoni nevojat e mia, fotokopje, aktualisht vetëm në gjuhën shqipe, 2018, Intervista me ekspertin e arsimit parauniversitar dhe intervistë me OSHC-të që punojnë me persona me nevoja të veçanta, prill 2020

Nxënësit e nivelit parafilior, fillor, të mesëm

Kosova ka dy shkolla të veçanta dhe pesë qendra burimore për fëmijët me NVA.⁹³ Gjatë vitit akademik 2018/2019, gjithsej 365 nxënës vijuan qendrat burimore dhe shkollat e veçanta, 59% e të cilëve ishin djem dhe 41% e të cilëve ishin vajza. Në fakt, të dhënat tregojnë qartë se vajzat me NVA janë shumë të nënpërfaqësuar në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Kjo bëhet edhe më alarmante kur kemi parasysh se të dhënat e regjistrimit të popullsisë tregojnë se në përgjithësi ka më shumë gra dhe vajza me nevoja të veçanta në Kosovë. Arsyet për këtë nënpërfaqësim mbeten të paqarta, por është vlerësuar që familjet mund të vendosin t'i dërgojnë djemtë e tyre me nevoja të veçanta në shkollë kur përballen me burime të kufizuara, në krahasim me vajzat e tyre.⁹⁴ Djemtë dhe vajzat me NVA përballen me disa vështirësi gjatë vijimit të arsimit, duke përfshirë mungesën e asistentëve personalë, klasat e mbipopulluara, mungesën e infrastrukturës fizike për nxënësit, mungesën e materialeve për fëmijët me paaftësi në dëgjim dhe shikim.⁹⁵ Të dhënat nga e gjithë bota tregojnë se vajzat me aftësi të kufizuara përballen me diskriminim të dyfishtë në të gjitha fushat e lartpërmendura.⁹⁶ Deri më tani nuk ekziston një analizë e thellë gjinore e nxënësve me NVA në Kosovë.

Grafiku. 4 nxënës në Qendrat Burimore/shkollat e veçanta



“Për shkak të stereotipeve të përgjithshme gjinore, vajzat me NVA përballen me diskriminim të dyfishtë nga familjet e tyre, përfshirë edhe qasjen në arsim. Fatkeqësisht deri më tani nuk ka pasur analiza të thella mbi këtë temë”

OSHC-të që punojnë me persona me nevoja të veçanta

Menaxhimi, rolet ekzekutive, profilet e mësimdhënies dhe rolet administrative

Tabela 5. Të dhëna e zbërthyer sipas gjinisë për stafin në qendrat burimore dhe shkollat e veçanta

Gjinia	Drejtorë	Administratori Stafi	Mësimdhënës	Stafi teknik
Gra	4	1	119	21
Burra	3	3	24	28
Gjithsej	7	4	143	49

93 Intervistë me disa zyrtarë të MASH

94 Intervista me zyrtarë të MASH, intervistë me OSHC-të që punojnë me persona me nevoja të veçanta, dhe Farnsworth, Morina dhe Nuhui, “Vlerësimi gjinor, LGBTI-së dhe i personave me aftësi të kufizuara”, 2018, në: <https://www.edu-links.org/sites/default/files/media/file/Gender-LGBTIP-WD%20assessment%20Kosovo%202018.pdf>

95 Po aty

96 Harilyn Rousso, Arsimim për të gjithë: Një perspektivë gjinore dhe e aftësive të kufizuara, 2003, në: <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000146931>

Nga shtatë shkollat që punojnë me fëmijë me NVA, katër shkolla kanë gra drejtore dhe tre kanë burra drejtorë.⁹⁷ Burrat janë të nënpërfaqësuar si mësimdhënës në qendrat burimore dhe shkollat e veçanta. Burrat mund të jenë të nënpërfaqësuar për shkak të faktit se rolet tradicionale gjinore, sipas të cilave gratë janë kujdestare kryesore të anëtarëve të familjes, kanë kaluar edhe në sektorin e arsimit.⁹⁸ Hulumtimi i përgjithshëm mbi ndikimin e stereotipeve gjinore në arsim në Kosovë ka vlerësuar se për shkak të stereotipeve gjinore, vajzat kanë tendencë të kërkojnë profesione në lidhje me “ndihmën ndaj të tjerëve” shumë më tepër sesa djemtë.⁹⁹ Këto vendime stereotipike të karrierës kanë një ndikim në tregun e përgjithshëm të punës në Kosovë, përfshirë arsimin, dhe shpjegojnë mospërputhjet e mëdha midis burrave dhe grave si mësimdhënësit në qendrat burimore dhe shkollat e veçanta.

Analiza gjinore e sektorit të arsimit: Komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptianë

Kosova është e banuar nga disa etni të ndryshme, përfshirë shqiptarët, serbët, turqit, boshnjakët, romët, ashkalinjtë, egjiptianët, goranët, kroatët dhe të tjerët. Për qëllimet e këtij studimi ne po përqendrohemi vetëm te komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë tregojnë se 0.51% e popullsisë së Kosovës janë romë (0.25 burra dhe 0.25 gra), 0.89% janë ashkali (përfshirë 0.45 burra dhe 0.44 gra), dhe 0.66% janë egjiptianë (përfshirë 0.33% burra dhe 0.33% gra).¹⁰⁰

Tabela 6. Komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë në Kosovë, zbërthyer sipas gjinisë.²

Rom			Ashkali			Egjiptian		
Gjithsej	Burra	Gra	Gjithsej	Burra	Gra	Gjithsej	Burra	Gra
0.50%	0.25%	0.25%	0.89%	0.45%	0.44%	0.66%	0.33%	0.33%

Siç është paraqitur më lart, situata në lidhje me qasjen në arsim mbetet veçanërisht e rëndë për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë në Kosovë, të cilët vazhdojnë të përballen me diskriminim dhe marginalizim, veçanërisht gratë.¹⁰² Ndërsa kjo ka çuar në uljen e qasjes në shërbimet publike për të gjitha komunitetet, situata është veçanërisht e rëndë për gratë, të cilat kanë qasje shumë të ulët në shërbimet publike, veçanërisht shërbimet shëndetësore.¹⁰³ Për më tepër, kushteve të këqija të banimit shtojnë rrezikun e shëndetit publik, duke prekur veçanërisht gratë që kalojnë më shumë kohë brenda shtëpive në krahasim me burrat nga këto komunitete.¹⁰⁴

97 Të dhënat e marra nga zyrtarët e MASH-t për qëllimet e këtij studimi, prill 2020.

98 Intervistë me ekspertin e arsimit parauniversitar, prill 2020

99 Po aty.

100 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Platforma ASKData, “Popullsia sipas Gjinisë në Kosovë, 2011”

101 Po aty.

102 Komisioni Evropian, Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit, Raporti 2019 për Kosovë*, në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>

103 Qendra Kosovare për Studime Gjinore, Pozita e Grave të Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas në Kosovë, 2003, në: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20130529134917547.pdf>

104 Po aty.

Nivelet e varfërisë dhe papunësisë mbeten të larta në nivel alarmant, edhe kur krahasohen me komunitetet e tjera në Kosovë.¹⁰⁵ Raportet tremujore të aktiviteteve të punësimit dhe tregut të punës të Agjencisë së Statistikave të Kosovës nuk i ndjekin normat e punësimit të burrave dhe grave të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Sidoqoftë, gjatë regjistrimit të fundit të popullsisë të kryer në vitin 2011, 2.053 qytetarë romë, ashkali dhe egjiptianë ishin të punësuar zyrtarisht, dhe vetëm 260 prej të cilëve ishin gra.¹⁰⁶ Krahasuar me të dhënat e popullsisë, kjo tregon se mezi 4.2% e grave të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë ishin të punësuar.¹⁰⁷ Situata kalon në arsim, me një normë regjistrimi që vazhdon të jetë dukshëm nën mesataren, dhe shumë të rinj romë, ashkali dhe egjiptianë nuk arrijnë nivele më të larta arsimore.¹⁰⁸ Siç është detajuar në kapitullin më poshtë, një normë e lartë e braktisjes së shkollës në arsimin fillor dhe të mesëm është gjithashtu trend alarmues.¹⁰⁹

“Mundësitë e punësimit janë të pakta, veçanërisht për gratë, kështu që ato nuk shohin asnjë arsye se pse duhet të vazhdojnë shkollimin dhe përkundrazi shohin një të ardhme më konkrete në martesat e hershme dhe përkujdesjen ndaj fëmijëve”

Drejtori Ekzekutiv i OSHC-së për të Drejtat e Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve

Nxënësit e nivelit parafillor, fillor dhe të mesëm

Tabela 7. Nxënësit në edukimin parashkollor dhe arsimin parafillor të zbërthyer sipas përkatësisë etnike

Përkatësia etnik	Rom	Ashkali	Egjiptian
Parashkollor	0.10%	0	0
Parafillor	0.51%	1.12%	0.35%
Fillor dhe i mesëm i ulët	0.64%	1.46%	0.36
I mesëm i lartë	0.20%	0.32%	0.20%

Në përgjithësi, fëmijët me përkatësi romë, ashkali dhe egjiptiane janë mjaft të nënpërfaqësuar në edukimin parashkollor në të gjitha komunat e Kosovës. Vetëm 4 fëmijë me përkatësi romë vijuan edukimin parashkollor gjatë vitit akademik 2018-2019. Ata përfaqësuan 0.10 të të gjithë nxënësve që vijojnë edukimin parashkollor në Kosovë. Të katër fëmijët ishin në Komunën e Gjakovës. Asnjë fëmijë me përkatësi ashkali ose egjiptiane nuk ka vijuar edukimin parashkollor gjatë këtij viti akademik. Kjo përfshin të gjitha komunat, përfshirë komunat me një numër të lartë të qytetarëve ashkali dhe egjiptian si Fushë Kosova, Peja dhe Gjakova.

Nuk ka të dhëna të disponueshme publike të zbërthyer sipas gjinisë për vijueshmërinë e edukimit parashkollor të etnive të ndryshme. Situata bëhet shumë më alarmante në nivelin e arsimit të mesëm të lartë, me të tre etnitë të

“Ne kurrë nuk duhet të nënvlerësojmë se si diskriminimi nga bashkëmoshatarët dhe mësimdhënësit kontribuon që vajzat dhe djemtë romë, ashkali dhe egjiptianë të mos vijojnë arsimin parauniversitar”

Ekspert për arsim parauniversitar

105 Ambasada e Suedisë në Prishtinë, Analiza shumëdimensionale e varfërisë, Kosovë 2017, në: <https://www.sida.se/globalassets/sida/eng/partners/poverty-toolbox/kosovo-mdpa.pdf>

106 Donika Lamaxhema “Jeta e Padukshme e Grave Rome, Ashkalinje dhe Egjiptiane në Periferi”, 2019 në: <https://kosovotwopointzero.com/en/roma-ashkali-and-egyptian-womens-invisible-lives-in-societys-outskirts/>

107 Po aty

108 Komisioni Evropian, Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit, Raporti 2019 për Kosovë*

109 Po aty

nënpërfaqësuar shumë. Kjo tregon që normat e braktisjes midis arsimit të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë janë shumë të larta si për djemtë ashtu edhe për vajzat. Sidoqoftë, vajzat me përkatësi rome, ashkali dhe egjiptiane janë të nënpërfaqësuar në arsimin e mesëm të lartë (Tabela 9).¹¹⁰ Braktisja e lartë në përqindje në krahasim me arsimin fillor dhe të mesëm të ulët tregon se normat e braktisjes në këtë nivel janë veçanërisht të larta, dhe veçanërisht të larta për vajzat nga të tri etnitë.

Tabela 9 Të dhëna të zbërthyera sipas gjinisë për vijimin e shkollimit parauniversitar të nxënësve romë, ashkali dhe egjiptianë

	Rom		Ashkali		Egjiptian	
	Djem	Vajza	Djem	Vajza	Djem	Vajza
Niveli shkollor						
Parashkollor dhe parafillor	52%	48%	49%	51%	62%	38%
Fillor dhe i mesëm i ulët	54%	46%	51%	49%	52%	48%
I mesëm i lartë	61%	39%	58%	42%	58%	42%

Për më tepër, vajzat egjiptiane janë të nënpërfaqësuar në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Disa faktorë luajnë rol në normat më të larta të braktisjes së arsimit nga vajzat. Kjo përfshin një mentalitet të përgjithshëm patriarkal, diskriminim ndër-sektorial me bazë racore dhe gjinore, perceptime të rrënjosura thellë për rolet tradicionale gjinore, si dhe kushtet ekonomike dhe sociale.¹¹¹ Megjithatë, martesat e hershme mund të luajnë një rol të shtuar në vajzat rome, ashkali ose egjiptiane që e braktisin arsimin.¹¹² Në fakt, është konfirmuar që martesat e hershme janë me të vërtetë praktika të zakonshme midis komuniteteve sipas analizës. Analiza e mëparshme ka zbuluar se afërsisht 12% e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë, shumica e të cilëve janë vajza martohen para se të mbushin 15 vjeç.¹¹³

“Nuk ka pasur ndonjë hulumtim të thelluar për këtë, por unë besoj se djemtë braktisin më shumë për shkak të punës së fëmijëve, ndërsa vajzat priren të braktisin për shkak të martesave të hershme, dhe duke u kujdesur për vëllezërit e motrat më të vogla. Kemi nevojë për më shumë hulumtime mbi këtë”

OSHC që punon me fëmijë të cenueshëm

Në përgjithësi, arsimi cilësor i vajzave dhe djemve romë, ashkali dhe egjiptianë përballet me disa vështirësi, përfshirë regjistrimin e pamjaftueshëm në shkollimin e detyrueshëm, normat e larta të braktisjes së shkollës dhe mungesën e teksteve shkollore në gjuhën rome.¹¹⁴ Këto probleme, ndër të tjera, kanë çuar në vijueshmëri të parregullt dhe regjistrim me vonesë në shkollë.¹¹⁵ Përbalja me diskriminimin e vazhdueshëm nga bashkëmoshatarët, si dhe nga mësimdhënësit, në disa raste, kontribuon në një nënpërfaqësim të përgjithshëm në arsimin parauniversitar.¹¹⁶ Gjatë vitit

110 Të dhënat e paraqitura nga MASH për qëllimet e këtij studimi, prill 2020.

111 Qendra Kosovare për Studime Gjinore, “Pozita e Grave të Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas në Kosovë, 2013, në: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20130529134917547.pdf>

112 Shih Qendrën Evropiane për Çështje të Minoriteteve, “Komunitetet në Kosovë: Një manual udhëzues për profesionistë që punojnë me komunitete në Kosovë, 2013, në: www.ecmikosovo.org/uploads/ECMIKosovoDec2013GuidebookforProfessionalsENG.pdf dhe Qendrën Kosovare për Studime Gjinore, “Pozita e Grave të Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas në Kosovë, 2013; një lidhje midis martesave të hershme dhe braktisjes së shkollës për vajzat nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë ishte gjithashtu një temë e përsëritur përmes shumë intervistave, përfshirë intervistat me zyrtarin e MASH-t dhe Drejtorin Ekzekutiv të OSHC-së për të Drejtat e Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve, dhe OSHC-të që punojnë me fëmijët e cenueshëm, dhe me OSHC-të që punojnë me komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë. Prill 2020

113 Qeveria e Shteteve të Bashkuara, Raporti i viti 2019 i të Drejtave të Njeriut në Kosovë, 2019, në: <https://www.state.gov/wp-content/uploads/2020/02/KOSOVO-2019-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf>

114 Intervistë me zyrtarin e MASH, prill 2020.

115 Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve, “Komunitetet në Kosovë: Një libër udhëzues për profesionistët që punojnë me komunitetet në Kosovë, 2013,

116 Intervistë me ekspertin e arsimit parauniversitar, prill 2020

akademik 2018/2019, MASH u ka ofruar 600 nxënësve romë, ashkali dhe egjiptianë bursa për të vijuar arsimin e mesëm të lartë, 53% e të cilëve ishin vajza dhe 47% ishin djem.¹¹⁷ Kishte kritere të ndryshme përzgjedhjeje, përfshirë masat afirmative për vajzat. Kritere të tjera përfshinin sukseset paraprake dhe notat shkollore, vendndodhjen (nëse nxënësit jetonin larg shkollës dhe duhej të udhëtonin); pa prindër; dhe një deklaratë nga Qendrat e Mirëqenies Sociale duke deklaruar se fëmija jeton në kushte të vështira sociale dhe ekonomike

Menaxhimi, rolet ekzekutive, profilet e mësimdhënies dhe rolet administrative

Mësimdhënësit romë, ashkali dhe egjiptianë janë shumë të nënpërfaqësuar në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në Kosovë. Vetëm 0.03% e mësimdhënësve janë romë, vetëm 0.03% janë ashkali dhe vetëm 0.02% janë egjiptianë. Këto të dhëna nuk janë të disponueshme siç janë të zbërthyer sipas gjinisë. Nuk ka të dhëna të disponueshme për stafin mbështetës dhe administrativ të zbërthyer sipas përkatësisë etnike dhe as gjinisë. Varfëria e përhapur, mungesa e qasjes në arsim dhe mungesa e mundësive të punësimit janë theksuar si arsye të mundshme për një nënpërfaqësim të përgjithshëm në punësim, përfshirë arsimin.¹¹⁸

117 Intervistë me zyrtarin e MASH, prill 2020

118 Intervistë me ekspertin e arsimit parauniversitar dhe intervistën me OSHC që punojnë për të drejtat e pakicave në Kosovë, prill 2020

Rekomandimet

- 1) MASH duhet të shqyrtojë mënyrën për t'i dhënë përparësi inkurajimit të burrave të rinjë që të zgjedhin karrierën e mësimdhënësit në edukimin e hershëm, siç është niveli parashkollor, parafillor dhe klasat e ulta fillore. Kjo mund të bëhet në disa mënyra.
 - a)** Përmes shkollave të mesme dhe këshillimit në karrierë, të inkurajohen burrat e rinjë që të studiojnë në fakultetin e edukimit në nivelin universitarë, në mënyre që të kualifikohen mësimdhënës për nivelet parashkollore.
 - b)** Të shqyrtojë mundësinë e përdorimit të nxitjeve të ndryshme për burrat e rinjë që të drejtohen për karrierë në mësimdhënie në arsimin e hershëm. Dispozitat mbi përfaqësimin e barabartë të Ligjit për barazinë gjinore lejojnë që të përdoren masat afirmative për rritjen e përqindjes së burrave të rinjë të regjistruar. Kjo për shembull mund të bëhet në formë të bursave të përcaktuara apo poenave shtesë për burrat e rinjë gjatë procesit të aplikimit.**
- 2) Në bashkëpunim me Agjencinë për Barazi Gjinore dhe Organizatat e Grave të Shoqërisë Civile, MASH duhet të analizojë kapacitetet dhe njohuritë e mësimdhënësve në nivelin parafillor, fillor dhe në shkolla të mesme në tërë Kosovën mbi përgjegjësitë e tyre ndaj PSO. Një analizë e tillë nuk është bërë asnjëherë, dhe nuk dihet në tërësi nëse mësimdhënësit i dinë përgjegjësitë e tyre, dhe si reagojnë ndaj tyre. Opinione e ekspertëve mbi këtë çështje janë të ndara, ka prej atyre të cilët besojnë se kjo nuk qëndron, por nevojiten informata të detajuara.
 - a.** Pas kësaj analize duhet të shyrtohet seriozisht mundësia e ngritjes së kapaciteteve mbi PSO për mësimdhënësit mbarë në Kosovën në nivelet parafillor, fillor dhe të mesëm. Kjo mund të bëhet në formë të punëtorive dhe mentorimeve të rregullta. Njohuritë mbi PSO dhe veprimet adekuate të ndërlidhura në rast të dyshimeve apo rasteve të identifikuar të dhunës në familje duhet të jenë pjesë e rregullt e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve.**
- 3) Në bashkëpunim me donatorët dhe organizatat ndërkombëtare, MASH duhet të shqyrtojë mundësinë e kryerjes së një studimi të ndjeshme ndaj gjinisë, mbi dhunën në shkolla, në të cilën do të analizoheshin format dhe frekuenca e dhunës që përjetohet nga fëmijë të ndryshëm, duke përfshirë djemtë dhe vajzat me NVA dhe komunitetet jo-shumicë. Kjo do të ndihmonte bërjen e politikave dhe programeve kundër dhunës ndaj fëmijëve.**
- 4) Ministria duhet të evitojë rreptësishtë programet/kampanjat e verbëra gjinore për parandalimin e braktisjes së shkollës. Arsyet për braktisjen e shkollës dallojnë qenësisht në mes të vajzave dhe djemve në përgjithësi, por poashtu në mes të komuniteteve të ndryshme. Në mes tjerash, iniciativat për ndalimin e braktisjes së shkollës duhet të jenë të bazuara në informata të bazuara mbi fakte të ndryshme duke përfshirë:
 - i.** Numër konsiderueshëm më i madh i djemve se i vajzave e braktisin shkollën;
 - ii.** Djemtë dhe vajzat kanë arsye shumë të ndryshme dhe motive se pse e braktisin shkollën;
 - iii.** Martesat e herrshme mund të luajnë rol të madh tek vajzat Rome, Ashkalinje dhe Egjiptase në braktisjen e shkollës në nivelin parauniversitar.**
- 5) Faktet dëshmojnë që në mungesë të këshillimit adekuat në karrierë, burrat e rinjë dhe gratë e reja i bazojnë zgjedhjet e tyre të karrierës në bazë të stereotipeve. MASH duhet t'i ndërmarrë disa hapa në mënyrë që kjo çështje të përmirësohet:
 - a.** Të përmirësohen shërbimet e këshillimit në karrierë në të gjitha shkollat e mesme dhe të mbahet trajnim i ndjeshëm ndaj gjinisë për të gjithë këshillëdhënësit në mbarë Kosovën
 - b.** Në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale të ndajë resurse për kryerjen e një analize të ndjeshme gjinore të tregjeve të punës mbi "Profesionet e të**

ardhmes". Kjo do t`u mundësonte djemve dhe vajzave që të familjarizohen me mundësitë në karrierë dhe t`u mundësojë që të marrin vendime të informuara lidhur me karrierat e tyre, në krahasim me vendimet e marra bazuar në ato të rrënjosura bazuar në stereotipe gjinore

- c. Të organizohen kampanja vetëdijësuese të synuara që në fokus kanë gratë e reja dhe vajzat dhe t`i inkurajojë ato që të shfrytëzojnë mundësitë e përcjelljes së shkollave profesionale
- d. Të merret parasysh hartimi i programeve të mentorimit me modele të suksesshme të grave në profesionet "jo tipike" për gratë.
- e. Sipas rekomandimeve të [Helvetas](#), të shqyrtohet mundësia e hartimit të një "Udhëzues për prindër mbi planifikimi ne karrierës". Kjo mund t`u ndihmojë prindërve që t`i përkrahin fëmijët e tyre që t`a përzgjedhin interesimin dhe karrierën në të ardhmen, jo të bazuara mbi stereotipet gjinore.

6) Para se të krijohen politika ose programe të ardhshme për qasjen e fëmijëve me NVA, të kryehet një analizë e synuar për të kuptuar se pse më pak vajza me NVA vijojnë mësimin krahasuar me djemtë me NVA. Të gjitha politikat e ardhshme duhet të bazohen në gjetjet e kësaj analize.

7) MASH duhet të ndërmarrë veprime të bazuara në prova dhe të synuara lidhur me nën-përfaqësimin e vajzave në arsimin parashkollor. Aktivitetet konkrete duhet të planifikohen pas një analize të situatës, por mund të përfshijnë aktivitete sensibilizuese me prindërit, si dhe sigurimin e transportit falas për studentët që jetojnë në zona të thella.

Shtojca 1. Plani i Veprimit Gjinor II i BE-së dhe Ekzaminimi i Shënuesve Gjinorë të OBZHE-së

Plani i Veprimit Gjinor II

Dokumenti Punues për stafin "Barazia Gjinore dhe Fuqizimi i Grave: Transformimi i jetës së vajzave dhe grave përmes marrëdhënieve të jashtme të BE-së 2016-2020" u miratua në vitin 2015.¹¹⁹ Dokumenti, i referuar si Plani i Veprimit Gjinor (GAP II) ofron një kornizë llogaridhënie, monitorimi dhe vlerësimi që do të përdoret për matjen e progresit të barazisë gjinore. GAP II ka katër prioritetet tematike me disa objektiva dhe tregues secili. Të gjitha projektet e financuara ose zbatuara nga BE-ja ose shtetet anëtare, duhet të raportojnë kundrejt objektivave dhe treguesve brenda GAP II, të rëndësishëm për projektin e tyre.

Shënues gjinor i OBZHE-së

Shënuesi gjinor i OBZHE-it është një mjet statistikor i përdorur për qëllime monitorimi dhe llogaridhënie. Shënuesi gjinor përdor një shkallë tri-pikash (0, 1, dhe 2) për vlerësim të projekteve dhe programeve që synojnë barazinë gjinore si një objektiv të politikës.¹²⁰ Sipas GAP II, Shënuesi gjinor duhet të aplikohet në mënyrë sistematike, duke shmangur pikët e pajustificuara të Shënuesit gjinor 0.¹²¹ Në fakt, është vendosur një synim që 85% e të gjitha programeve të reja të financuara nga BE-ja duhet të kenë një rezultat të G1 dhe G2.

Shënuesi gjinor 0: Projekti/programi nuk është konstatuar se synon barazinë gjinore.

Shënuesi gjinor 1: Barazia gjinore është një objektiv i rëndësishëm dhe i qëllimshëm, por jo arsyeja kryesore për ndërmarrjen e projektit/programit.

Shënuesi gjinor 2: Barazia gjinore është objektiv kryesor i projektit/programit dhe është thelbësor në hartimin e tij dhe rezultatet e pritura. Projekti/programi nuk do të ishte ndërmarrë pa këtë objektiv të barazisë gjinore.

119 Komisioni Evropian, "Barazia Gjinore dhe Fuqizimi i Grave: Transformimi i jetës së vajzave dhe grave përmes marrëdhënieve të jashtme të BE-së 2016-2020", 2015, në: https://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/staff-working-document-gender-2016-2020-20150922_en.pdf.

120 OBZHE-KAZH Rrjeti për Barazinë Gjinore, Përkufizimi dhe Kriteret Minimale të Rekomanduara për Shënuesin e Politikës së Barazisë Gjinore KAZH, 2016, në: <https://www.oecd.org/dac/gender-development/Minimum-recommended-criteria-for-DAC-gender-marker.pdf>

121 Treguesi 5.3.1 dhe Treguesi 5.3.2 nën Objektivin 5

Shtojca 2: Persona të intervistuar

Persona të intervistuar			
Organizatë/Institucion	Pozita	Emri	Datë
MASH	Koordinator për të drejtat e njeriut	Merita Jonuzi	21.4.2020
MASH	Divizioni për Arsim i Komuniteteve	Nazan Safqi	20.4.2020 dhe 22.4.2020
Save the Children	Koordinator për zbatim të programeve	Valid Zhubi	23.4.2020
Save the Children	Koordinator	Rrita Limaj	23.4.2020
Ish-Drejtoresh e Këshillit Rinor Kosovar	Ekspert për arsim parauniversitar	Agnesa Qerimi	22.4.2020
HandiKos	Menaxher i programit	Durim Gashi	22.4.2020
Balkan Sunflowers Kosova	Drejtor Ekzekutiv	Muhamet Arifi	21.4.2020
Rrjeti i grave Rome, Ashkalinje dhe Egjiptiane	Drejtor Ekzekutiv	Shpresa Agushi	23.4.2020
Rrjeti i grave Rome, Ashkalinje dhe Egjiptiane	Menaxher i projektit	Adelina Qorraj	23.4.2020

Shtojca 3: Programet e vazhdueshme në sektorin e arsimit

Ndikimi i vetë-raportuar mbi barazinë gjinore përmes projekteve në sektorin e arsimit				
Organizimi	Projekti	Afati kohor	Përshkrimi i shkurtër	Si i merr parasysh projekti nevojat e ndryshme të burrave dhe grave/vajzave dhe djemve?
Balkan Sunflower Kosova	Rrjeti i Qendrave Mësimore	2007 - Vazhdon	<p>RRQM filloi në vitin 2008 me tri qendra në Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Plemetin. Në vitin 2009 u hap Qendra Mësimore në Shtime dhe në vitin 2013 RRQM-ja shtoi një qendër të dytë në Plemetin. Programet ofrohen në gjuhën shqipe dhe serbe. Përveç programeve parashkollore, mbështetjes së kurrikulës, shkrim-leximit dhe atyre shkencore, secila qendër ka një ndërmjetës arsimor që punon me shkolla dhe familje për të ulur braktisjet dhe për të rritur regjistrimin. Falë pjesës më të madhe të ndërmjetësve tanë arsimor, 93% e fëmijëve të kualifikuar në zonat ku ne punojmë regjistrohen në klasën e parë.</p>	<p>Balkan Sunflower ka siguruar që vajzat dhe djemtë të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga ky projekt gjatë gjithë zbatimit të tij. Stafi i Balkan Sunflower vlerëson se normat e pjesëmarrjes së vajzave dhe djemve qëndron në 50% për secilën. Balkan Sunflower kryen integrimin gjinor përmes të gjitha aktiviteteve të Qendrave Mësimore.</p> <p>Në vitin 2009, programet e shkrim-leximit të grave u inicuan në dy qendra, duke përdorur kurrikulën e hartuar nga UNICEF-i dhe MASH. Programet e shkrim-leximit të grave tani janë aktive në 3 qendra. Përveç përqendrimit në shkrim-lexim, gratë fitojnë ngritje kapacitësh në klasat e artizanatit dhe të parukerisë.</p> <p>Qendrat mësimore aktualisht po luftojnë për financim dhe po u drejtohen donatorëve të ndryshëm.</p>
Caritas-i zviceran	Vendosja e Standardeve me Cilësi të Lartë Parashkollore Përforcimi i Arsimit, Shkencës dhe Ekonomisë - SHPRESE	2018-2022	<p>Projekti SHPRESE synon përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe ofrimit të shërbimeve në arsimin parafillor në Kosovë. Vizioni ynë përqendrohet rreth një sistemi arsimor funksional, cilësor në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe Kornizën e Kurrikulit dhe Kurrikulën Bazë. Për më tepër, SHPRESE ngrit kapacitetet e institucioneve publike, kryesisht të Institutit Pedagogjik të Kosovës në ofrimin e trajnimeve dhe shërbimeve të tjera në APF (arsimin parafillor); Asociacioni i Komunave të Kosovës në avokimin për arsim cilësor në APF; zyrtarët e DKA-ve për grupin tonë të synuar; dhe Fakulteti i Edukimit në Gjakovë, në Gjilan, në Mitrovicë dhe në Prizren;</p>	<p>CaCH (Caritas-i zviceran) i bazon të gjitha veprimet e saj në premisën që qasja e barabartë në burimet ekonomike, sociale dhe politike formojnë një të drejtë themelore të njeriut. Burra dhe gra, djem dhe vajza, duhet të kenë mundësi të barabarta për zhvillim personal dhe formësimin e jetës së tyre. Projektet e CaCH janë gjithashtu të ndërgjegjshme për të shmangur përforcimin ose përjetësimin e pabarazive gjinore. Në pasojë, projekti SHPRESE u elaborua dhe u zhvillua duke marrë parasysh plotësisht këtë. Duke marrë parasysh që shumica e mësimdhënësve parafillorë janë gra, projekti ka inkurajuar angazhimin e Master Trajnerëve që janë burra (dhe aktualisht dy prej tyre janë të angazhuar), dhe do të kërkojë mundësi për t'u përfshirë në praktikatat e ofruara nga projekti në klasat e APF-së për nxënës meshkuj të cilët janë regjistruar në fakultetet e edukimit.</p>

<p>Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)</p>	<p>Zhvillimi i sektorit të arsimit themelor</p>	<p>2019-2021</p>	<p>Projekti operon nën objektivin e përmirësimit të parakushteve për sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor në Kosovë. Ai aplikon një qasje sistematike, shumë nivelëshe në trajtimin e problemeve bazë në arsimin themelor në Kosovë, duke mbuluar katër fusha të aktiviteteve: 1) Transparenca, llogaridhënia dhe pjesëmarrja e publikut; 2) Arsimimi universitar i mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave; 3) Qasja e integruar e zhvillimit të shkollave; 4) Promovimi i gjithëpërfshirjes, veçanërisht për pakicat etnike dhe të kthyerit</p>	<p>Veprimet e ndërmarra drejt barazisë gjinore dhe nevojave të ndryshme të burrave dhe grave:</p> <ul style="list-style-type: none"> -I kanë sugjeruar MASH-it të kryejë trajnime specifike sektoriale për ngritjen e kapaciteteve për çështjet gjinore; -E kanë mbështetur MASH-in në hartimin e raportit të monitorimit të zbatimit të PSAK-ut për vitin 2017. Gjinia konsiderohet vazhdimisht në raport dhe vlerësohet arritja e treguesve të ndjeshëm gjinor; -Kanë siguruar përfaqësim të barabartë të grave në trajnime, punëtori, konferenca dhe aktivitete të tjera, etj.; -Kanë siguruar që aktivitetet e zhvillimit të kapaciteteve janë të ndjeshme ndaj gjinisë përmes zhvillimit të materialeve për mësimdhënie dhe mësimnxënie me ndjeshmëri gjinore; -Kanë iniciuar dhe mbështetur iniciativa gjinore të shkollave veçanërisht në zonat rurale (me fokus në pjesëmarrjen e grave). -Kanë realizuar monitorimin e ndikimit të ndjeshëm ndaj gjinisë: zbërthimi sipas gjinisë dhe gjinia e pasqyruar në kornizën e treguesve të arritjeve/prodhimeve; -E kanë mbështetur dhe forcuar fokusin mbi gratë dhe vajzat nga zonat rurale, veçanërisht nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë. -Sa i përket ekspertëve, të cilët kanë ofruar ekspertizë për aktivitetet e projektit, CDBE ka ofruar mundësi të barabarta për të gjithë. <p>Kanë kërkuar nga partnerët zbatues, gjatë angazhimit të stafit të zbatojnë aktivitetet e komponentit për të marrë parasysh barazinë gjinore.</p>
--	---	------------------	---	---

<p>Qendra për arsim e Kosovës (KEC)</p>	<p>Mbështetja pas shkollore për adoleshentët (ASSET), financuar nga USAID</p> <p>http://asset-ks.org/</p>	<p>7 qershor 2017 - 6 qershor 2022</p>	<p>Qëllimi kryesor i ASSET është të zhvillojë aftësi sipërmarrëse dhe punësimi tek të rinjtë dhe një qëndrim pozitiv për të ardhmen e tyre.</p> <p>Slllogani i ASSET-it është: "Përgatitja e të Rinjve të Kosovës për jetë dhe punë në shekullin 21". Zhvillimi i Kompetencave të Jetës dhe Punës.</p> <p>Ky është një program 5-vjeçar i USAID-it, i menaxhuar nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), në partneritet me FHI 360 dhe Crimson Capital Corp.</p>	<p>Plani i Zbatimit Gjikor i Programit, në mbështetje të integritit të plotë gjikor të programit, përqendrohet në katër fusha të veçanta:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Hartimi dhe zhvillimi: Një klauzolë gjimore dhe barazie është futur në fushëveprimin e punës së të gjithë konsulentëve. Programi do të mbledhë të dhëna për një numër treguesish të arritjeve, përfshirë ata cilësorë, në lidhje me integrimin gjikor. Nëse gjendet një ndryshim i rëndësishëm statistikor, veprimi i duhur do të ndërmerret. Për më tepër, Programi ka një listë kontrolli për zhvillimin e kurseve, duke përfshirë një seksion mbi gjininë dhe barazinë (p.sh. "A janë shmangur stereotipet në shembujt e dhënë?") dhe të aplikojë në të gjitha materialet që do të zhvillohen. • Zhvillimi profesional: Ndërgjegjësimi gjikor i të gjithë audiencave të synuara do të monitorohet. Do të përdoren kurset e standardeve për lehtësuesit dhe mentorët e mësimdhënësve. Ky program përfshin një modul mbi gjininë dhe barazinë gjimore. Programi do të monitorojë vjueshmërinë e burrave dhe grave dhe mësimdhënësve të kombësive të ndryshme në të gjitha aktivitetet e zhvillimit profesional dhe të ndërmarrë veprimet e duhura nëse kërkohet. • Të rinjtë dhe aktivitetet të tjera: Puna me shkolla do të promovojë pjesëmarrjen aktive të vajzave dhe djemve në aktivitetet të tilla si rinovimi i qendrave, projekte shkollore, sfida, klube, sporte dhe gara. Një problem për vajzat që udhëtojnë nga zonat rurale është siguria personale gjatë udhëtimit në shtëpi nga aktivitetet e nxënësve. Programi do të punojë me komunën dhe organizatat partnere për të krijuar një sistem transporti për të adresuar këtë çështje. E njëjta qasje do të aplikohet në rast se nxënësit e grupeve të caktuara të pakicave do të kenë probleme me transportin. <p>Aktivitetet specifike gjimore: Bazuar në ngjarjet vjetore vendore ose ndërkombëtare (p.sh. Dita Ndërkombëtare ose Fëmija Vajzë) Programi do të organizojë ngjarje të ndërlidhura, në koordinim me partnerët e vet lokalë.</p>
---	--	--	---	--

KEC	Zgjerimi i qasjes në arsimin cilësor të fëmijërisë së hershme dhe arsimin fillor, financiar nga Fondi për Arsimin e Romëve (FAR)	1 tetor 2018 - 31 gusht 2021	Projekti synon të përmirësojë arritjet e ZHFH-së dhe gatishmërinë e shkollave për klasën 1 dhe 2 të fëmijëve të pafavorizuar romë nga gjashtë lagje të moshës 4-6 dhe 6-8 që vijojnë shkollat në dy lokacione duke përmirësuar shkathtësitë prindërore të prindërve, duke forcuar lidhjen midis prindërve dhe institucionet parafillore dhe shkollore, duke zgjeruar qasjen në shërbimet e integruara të ZHFH-së dhe duke rritur cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies.	<p>Aspektet e mëposhtme synohen për sa i përket integritimit gjinor:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të dhëna për përfituesit fëmijë: databaza e përfituesve fëmijë do të zbërthehen sipas gjinisë. Nëse gjendet një ndryshim i rëndësishëm statistikor, veprimi i duhur do të ndërmerret. • Hartimi dhe zhvillimi: Një klauzolë gjinore dhe barazie do të futet në fushëveprimin e punës së të gjithë konsulentëve. Projekti do të mbledhë të dhëna për një numër treguesish të arritjeve, përfshirë ata cilësorë, në lidhje me integritimin gjinor. • Zhvillimi profesional: Ndërgjegjësimi gjinor i të gjithë audiencave të synuara do të monitorohet. Projekti do të monitorojë vijueshmërinë e burrave dhe grave dhe mësimdhënësve të kombësive të ndryshme në të gjitha aktivitetet e zhvillimit profesional dhe të ndërmarrë veprimet e duhura nëse kërkohet. • Fëmijët dhe aktivitete të tjera: Puna me shkolla dhe komunitetin rom do të promovojë pjesëmarrjen aktive të vajzave dhe djemve në aktivitete ndërkulturore, dhe të prindërve femra dhe meshkuj në aktivitetet e projektit. Materialet dhe publikimet e projektit: Projekti do të sigurojë se ka aspekt gjinor të adresuar në materialet e publikuara. Për shembull, do të sigurohet që të përfshihet një numër i barabartë i djemve dhe vajzave në materiale promovuese, fotografi dhe raporte, dhe veçanërisht për të siguruar që stereotipet janë shmangur. Projekti do të sigurojë që të ofrojë materiale didaktike neutrale gjinore për fëmijët që marrin pjesë në aktivitetet e projektit.
KEC	Së bashku kundër abuzimit të fëmijës, të financuar nga Bashkimi Evropian www.childrights-ks.org	1 shkurt 2020-31 janar 2023	Projekti synon të mbrojë fëmijët nga abuzimi dhe, si i tillë, të kontribuojë drejtpërdrejt në promovimin e të drejtave të fëmijëve. Ai do të përqendrohet në mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe minimizimin e efekteve të përvojës së abuzimit duke përmirësuar kapacitetet e individëve dhe ato institucionale për parandalimin e abuzimit dhe mbështetjen e viktimave.	Ndjeshmëria gjinore: Aktivitetet e projektit do të përshtaten me nevojat dhe perspektivat dhe do të sigurojnë barazinë gjinore në zbatimin dhe vlerësimin e projektit. Aktivitetet e projektit do të sensibilizohen për nevojat e burrave dhe grave dhe do të shqyrtojnë ndikimin diferencues të iniciativave arsimore në marrëdhëniet shoqërore midis tyre.

KEC	Fuqizimi i të rinjve për një të ardhme paqësore, prosperuese dhe të qëndrueshme në Kosovë	2019 - 2020	Përmes këtij projekti, ne synojmë të krijojmë metodologji efektive dhe të trajtuar konfliktet në shkolla duke i zbatuar ato në 20 shkolla ku i gjithë komuniteti shkollor do të përfitonte. Përzgjedhja e shkollave do të bëhet në bashkëpunim me DKA-të nga komunat e përzgjedhura	Të gjithë treguesit e projektit do të raportohen të zbërthyer sipas gjinisë. Kjo do të thotë që në të gjitha aktivitetet e projektit, integrimi gjinor është një element kryesor që do të merret parasysh gjatë zbatimit të projektit.
KEC	Iniciativa për zvogëlimin e pabarazive në arsim (ARISE)	2020-2024	Objektivi i përgjithshëm: Për të forcuar kapacitetet e OSHC-ve për zhvillim politikash dhe avokim në fushën e barazisë arsimore përmes bashkëpunimit rajonal dhe ndërtimit të koalicioneve vendore Objektiva specifike: Për të mbështetur përfshirjen e nxënësve me status të ulët socio-ekonomik (SSE) duke ndërtuar partneritete kombëtare dhe rajonale të organizatave të shoqërisë civile nga gjashtë vende përfituese të IPA-s për t'u përfshirë në avokim dhe dialog politik konstruktiv me qeveritë, për të rritur ndërgjegjësimin midis palëve të interesit në arsim dhe ndërhyrjeve pilot që synojnë nxënësit me status të ulët socio-ekonomik në nivelin shkollor	Ky projekt ka disa tregues që janë hartuar bazuar në qasjen e ndjeshme ndaj gjinisë. Për më tepër, integrimi gjinor është një temë të ndërthurur në të gjitha aktivitetet. Progresi i zbatimit do të ndiqet dhe veprimet korrigjuese do të ndërmerren duke mbledhur të dhëna të zbërthyer sipas gjinisë, përkatësisë shoqërore, aftësisë së kufizuar, etj. Për më tepër, të gjitha materialet e krijuara me mbështetje nga projekti do të përdorin gjuhën specifike gjinore dhe do të promovojnë përfshirjen gjinore.
KEC	KRAEEYN (Rrjeti i romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve kosovarë për zhvillimin e fëmijërisë së hershme)	2016-2020	KRAEEYN është një rrjet i profesionistëve dhe i para-profesionistëve për zhvillimin e fëmijërisë së hershme të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në Kosovë. Deri më tani, rrjeti KRAEEYN ka individë dhe organizata anëtare që avokojnë për mirëqenien e fëmijëve nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë dhe përfshirjen e tyre në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës.	Aktivitetet e projektit janë dizajnuar që të jenë të ndjeshme ndaj gjinisë kur është e mundur, duke përfshirë: -vendosjen e synimeve të treguesve për barazinë gjinore për trajnim dhe mundësi të tjera të zhvillimit profesional për tutorët dhe lehtësuesit nga qendrat mësimore. - përgatitjen e materialeve promovuese dhe fushata avokimi duke promovuar përfshirjen gjinore

Rrjeti i grave rome, ashkali dhe egjiptiane	Mobilizimi i komunitetit drejt llogaridhënies sociale	Janar - dhjetor 2020	Projekti po implementohet në bashkëpunim me Save the Children dhe financohet nga SIDA. Projekti është duke u implementuar në tri komuna, përfshirë Prishtinën, Ferizajin dhe Mitrovicën. Qëllimi i tij është të rrisë pjesëmarrjen e të nxënësve dhe prindërve në proceset e vendimmarrjes dhe llogaridhënies	RROGRAEK siguron që perspektiva gjinore të përfshihet gjatë hartimit dhe zbatimit të aktiviteteve të projektit. Projekti përqendrohet në rritjen e pjesëmarrjes së vajzave në vendimmarrje dhe kërkimin e llogaridhënies sociale nga shkollat dhe strukturat komunale.
Save the Children në Kosovë	Kujdesi dhe zhvillimi gjatë fëmijërisë së hershme në Kosovë	2020-2022	Përmes këtij projekti, Save the Children synon që fëmijët e moshës 0-6 vjeç në Kosovë të gëzojnë të drejtat e tyre për zhvillim fizik, mendor, moral dhe shoqëror, duke u mundësuar atyre drejtpërdrejt të rriten në potencialin e tyre të plotë.	Ky projekt u krijua që të jetë i ndjeshëm ndaj gjinisë, sipas Shënuesit gjinor të Save the Children. Kur është e mundur, aktivitetet janë krijuar që të jenë të ndjeshme ndaj gjinisë. Kjo përfshin caktimin e synimeve të treguesve që përbëjnë barazinë, sigurimin e trajnimeve të ndjeshme ndaj gjinisë për edukatorët parashkollorë, organizimin e seancave nënë-vogëlush në zonat rurale dhe institucionet parashkollorë, dhe krijimin e fushatave të komunikimit dhe sensibilizimit të ndjeshëm ndaj gjinisë.
Save the Children në Kosovë	Veprimi për arsimin gjithëpërfshirës	2018 - 2020	Projekti synon fëmijë me përkatësi të cenueshme, përfshirë fëmijët me NVA dhe nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë dhe qasjen e tyre në arsim	Ky projekt u krijua që të jetë i ndjeshëm ndaj gjinisë, sipas Shënuesit gjinor të Save the Children. Synimet e treguesve të këtij projekti janë caktuar të ofrojnë barazi. Për më tepër, projekti kryesisht punon në rritjen e kapaciteteve të grave në sektorin e arsimit.
UNICEF në Kosovë	Arsimi gjithëpërfshirës - Trajnimi i mësimit në vend pune me fokus në fëmijët me aftësi të kufizuara	2018-2019	Qëllimi i projektit ishte rritja e kapaciteteve të mësimit në nivelin shkollor në komunat e përzgjedhura për të ofruar arsim gjithëpërfshirës me theks tek fëmijët me aftësi të kufizuara.	Të gjitha aktivitetet e programit të mbështetur nga UNICEF, përfshirë këtë, janë të ndjeshme ndaj gjinisë dhe janë përfshirë si pjesë e dimensionit të barazisë. Partneriteti i fortë midis UNICEF-it dhe institucioneve të nivelit qendror siç është Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe strukturat e saj të nivelit lokal ka mundësuar që mbi 500 vajza dhe djem nga 14 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta në të shtatë komunat e përzgjedhura të përfitojnë nga rritja e kapaciteteve të 200 mësimit në vend pune me theks tek djemtë dhe vajzat me NVA.

UNICEF në Kosovë	Parandalimi i braktisjes së fëmijëve nga shkolla	2018-2020	Projekti synon të rrisë kapacitetet në shkollë, institucione të nivelit komunal dhe qendror për të parandaluar, reaguuar dhe referuar rastet në rrezik nga braktisja nga shkolla (objektivat e vajzave dhe djemve nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë, familje të varfra, zona rurale, CËD)	<p>Të gjitha aktivitetet e programit të mbështetur nga UNICEF, përfshirë këtë, janë të ndjeshme ndaj gjinisë dhe janë përfshirë si pjesë e dimensionit të barazisë.</p> <p>Me mbështetjen e vazhdueshme teknike dhe financiare të UNICEF-it, zyrtarët e MASH-it dhe ata komunalë forcoan funksionalitetin e 100 ekipeve ekzistuese për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve (PRTAN) në 10 komuna. Si rezultat, 500 nxënës në rrezik të braktisjes së shkollës u identifikuan gjatë vitit 2019. Nga këta, 109 nxënës (22 për qind) me sukses i adresuan sfidat e tyre personale dhe mbetën në shkollë. Të gjithë fëmijët e identifikuar në rrezik për të braktisur shkollën janë kapur nga Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm (EWS) SIMA i MASH-it.</p>
UNICEF në Kosovë	Akreditimi i aftësive për programin e jetës	2019-2020	Akreditimi dhe integrimi i programeve të UNICEF-it për shkathtësi për jetë dhe punë (UPSHIFT, PONDER dhe PODIUM) në kurrikulën ekzistuese të arsimit të mesëm.	<p>Të gjitha aktivitetet e programit të mbështetur nga UNICEF, përfshirë këtë, janë të ndjeshme ndaj gjinisë dhe janë përfshirë si pjesë e dimensionit të barazisë.</p> <p>Vajzat dhe djemtë në dekadën e tyre të dytë të jetës vazhdojnë të luftojnë për të lundruar me sukses në tregun kompleks të punësimit në Kosovë. Për të zvogëluar mospërputhjen midis prodhimeve të sistemit arsimor dhe mundësive të tregut të punës, UNICEF-i, në bashkëpunim të ngushtë me MASH-in, filloi procesin e akreditimit dhe integrimin të programeve të UNICEF-it për shkathtësi për jetë dhe punë (UPSHIFT, PONDER dhe PODIUM) në kurrikulën ekzistuese të arsimit të mesëm. Vetë projekti thekson që të arrihen dhe angazhohen vajzat dhe djemtë e rinj nga grupet më të cenueshme në tërë Kosovën.</p>

UNICEF në Kosovë	Rishikimi i Ligjit mbi Edukimin Parashkollor	2019-2020	Përmes kësaj mbështetje UNICEF-i siguron që të drejtat e të gjithë fëmijëve (vajza dhe djem, fëmijë nga grupet etnike minoritare, fëmijë me aftësi të kufizuara) respektohen dhe adresohen	<p>Të gjitha aktivitetet e programit të mbështetur nga UNICEF, përfshirë këtë, janë të ndjeshme ndaj gjinisë dhe janë përfshirë si pjesë e dimensionit të barazisë.</p> <p>UNICEF i siguroi asistencë teknike MASH-it për të hartuar Ligjin mbi Edukimin Parashkollor i cili është në përputhje me dispozitat përkatëse të CRC-së. Ligji ka për qëllim të sigurojë një mjedis të sigurt dhe mbrojtës për fëmijët (vajzat dhe djemtë) në arsimin parashkollor. Në nivelin kombëtar, u krijua një mekanizëm i koordinimit të zhvillimit të fëmijërisë së hershme për të avokuar për rritjen e burimeve njerëzore dhe financiare për ndërhyrjet në zhvillim të fëmijërisë së hershme - duke përfshirë shërbimet e komunikimit për fëmijët e cenushtëm siç janë ata nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë dhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Përmes partneriteteve të reja me OJQ-të lokale dhe mbështetjes teknike të drejtpërdrejtë për MASH-in dhe institucionet vendore, u krijuan katër qendra të reja për ZHFH me bazë komunitare në katër komuna të përzgjedhura. Këto qendra të reja për ZHFH do të jenë të arritshme për vajzat dhe djemtë nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë dhe fëmijët me NVA.</p>
------------------	--	-----------	--	--

Bibliografia

- Agjencia për Barazi Gjinore Procedurat Standarde të Operimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë, 2013, në:https://www.psh-ks.net/repository/docs/Procedurat_Standarde_te_Veprimit_per_Mbrojtje_nga_Dhuna_ne_Familje.pdf
- Agjencia e Statistikave të Kosovës, Platforma ASKData, "Popullsia sipas Gjinisë në Kosovë, 2011", në: https://askdata.rks-gov.net/PXËeb/pxëeb/en/askdata/askdata__09%20Population__Population%20Structure/Population%20by%20sex%20and%20years%201921-2011%20in%20Kosovo.px/table/tableVieëLayout1/?rxid=6c75a9aa-627c-48c6-ae74-9e1b95a9c47d
- Për më tepër në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>
- Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, 2015, në: www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L019%20a.pdf
- Ligji Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore, 2015, në: equineteurope.org/ëp-content/uploads/2019/10/Annex-LAË_NO_05_L-020_ON_GENDER_EQUALITY.pdf
- Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 2015, në: equineteurope.org/ëp-content/uploads/2019/10/Annex-LAW_NO_05_L-021_ON_THE_PROTECTION_FROM_DISCRIMINATION.pdf
- Ligji Nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, 2010, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2691&langid=2>
- Qendra për Gjininë në Organizata, Dreaming Big: Çfarë ka gjinia të bëjë me të? Ndikimi i stereotipeve gjinore në aspiratat e karrierës së shkollarëve të arsimit të mesëm, 2012, në: <https://www.simmons.edu/sites/default/files/2019-03/Insights%2035.pdf>
- Donjeta Morina për ERAC, "Dhuna me Bazë Gjinore në Kosovë: Shqyrtim kritik i reagimit të policisë, dhjetor 2019, në: http://kgscenter.net/site/assets/files/1742/gender_base_violence_eng-1.pdf
- Ambasada e Suedisë në Prishtinë, Analiza shumëdimensionale e varfërisë, Kosovë 2017, në: <https://www.sida.se/globalassets/sida/eng/partners/poverty-toolbox/kosovo-mdpa.pdf>
- Komisioni Evropian, "Një metodë e re për të kuptuar ndarjen gjinore në profesione në tregjet evropiane të punës, 2015, në: <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/2f6938c9-86ac-11e5-b8b7-01aa75ed71a1/language-en>
- Komisioni Evropian, "Barazia Gjinore dhe Fuqizimi i Grave: Transformimi i jetës së vajzave dhe grave përmes marrëdhënieve të jashtme të BE-së 2016-2020", 2015, në: https://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/staff-ëorking-document-gender-2016-2020-20150922_en.pdf
- Komisioni Evropian, Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit, Raporti 2019 për Kosovë*, në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>
- Farnsëorth, Morina, dhe Nuhiu, "Vlerësimi gjinor, LGBTI-së dhe i personave me aftësi të kufizuara", 2018, në: <https://www.edu-links.org/sites/default/files/media/file/Gender-LGBTIPËD%20assessment%20Kosovo%202018.pdf>
- Qeveria e Kosovës, Rregullorja Nr. 21/2013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-universitar, 2013, në: kryeministri-ks.net/repository/docs/RREGULLORE_QRK-_NR__21_2013_PER_PROTOKOLLIN_PER_PARANDALIMIN_DHE_REFERIM....pdf
- Grown, Gupta dhe KES për Projektin e Mijëvjeçarit të OKB-së: "Ndërmarrja e veprimit (Taking Action): Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave", 2012, faqe 37, në: <https://books.google.com/books?hl=en&lr=&id=dP-SRE4ËCJEC&oi=fnd&pg=PR3&dq=Education+and+gender+equality&ots=OpUc2ëFODË&sig=TJK1vmf-OqpMS1a4R0hTSIKmKF8#v=onepage&q&f=false>

- Ingvild Almas Alexander et al. Çfarë shpjegon hendeku gjinor në normë të lartë i braktisjes së shkollës? Provat eksperimentale dhe administrative, 2015
- Jennifer Rothchild, "Edukimi i Krijuesve të Problemeve Gjinore dhe Fuqizimi në Nepal", faqe 92, 2007, Raporti i shtypur
- Jin Chi, Shtigje për barazinë gjinore përmes fëmijërisë së hershme politike për mësimdhënës në Kinë, 2018, Fletë diskutimi, në: <https://files.eric.ed.gov/fulltext/ED592783.pdf>
- Agjencia e Statistikave të Kosovës, Anketa e Fuqisë Punëtore TM4 2019, në: <https://ask.rks-gov.net/media/5365/afp-tm4-2019.pdf>
- Qendra Kosovare për Studime Gjinore, Pozita e Grave të Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas në Kosovë, 2003, në: <https://ëomensnetëork.org/ëp-content/uploads/2018/10/20130529134917547.pdf>
- Rrjeti i Grave të Kosovës, Analiza Gjinore e Kosovës, 2018, në: <https://womensnetwork.org/ëp-content/uploads/2018/10/womens-network.pdf>
- Rrjeti i Grave të Kosovës, Mjaft më me arsytetime: Analizë e qëndrimeve, incidencës dhe reagimeve institucionale ndaj dhunës në familje në Kosovë, 2015, në: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20151124105025622.pdf>
- Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit, Studimi i Fuqisë Punëtore të Kosovës dhe Studimi i Shfrytëzimit të Kohës, Faqe 18, 2018, në: <https://millenniumkosovo.org/ëp-content/uploads/2018/11/MCC-Kosovo-Labor-Force-and-Time-Use-Study-Final-Research-Report-1.pdf>
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, "Statistikat e Arsimit në Kosovë", 2018-2019, në: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/08/education-statistics-2018-2019.pdf>
- Morina dhe Farnsëorth, Buxheti drejt një arsimit më të mirë: Analizë gjinore e shpenzimeve dhe shërbimeve në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 2015, në: <https://ëomensnetëork.org/wp-content/uploads/2018/10/20160607151528942.pdf>
- Morina dhe Farnsëorth, Buxheti drejt një arsimit më të mirë: Analizë gjinore e shpenzimeve dhe shërbimeve në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 2015, në: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20160607151528942.pdf>
- Morina dhe Farnsworth, "Ligji i ri i Kosovës për Barazinë Gjinore: Të mirat, të këqijat, të diskutueshme, 2015, në: <https://womensnetwork.org/kosovorsquos-neë-laë-on-gender-equality-the-good-the-bad-the-questionable/>
- Raport kombëtar kollokuimi, "Trajnimi për shkathtësi profesionale dhe jetësore të vajzave adoleshente jashtë shkollës në grupmoshën 15-18, 2015, në: <https://ncpcr.gov.in/showfile.php?lang=1&level=1&&sublinkid=1357&lid=1558>, dhe SIDA, Perspektivat gjinore mbi shkaqet dhe efektet e braktisjes së shkollës, 2016, në: www.ungei.org/Final_Paper_on_Gender_perspectives_C2.pdf
- OBZHE-KAZH Rrjeti për Barazinë Gjinore, Përkufizimi dhe Kriteret Minimale të Rekomanduara për Shënuesin e Politikës së Barazisë Gjinore KAZH, 2016, në: <https://www.oecd.org/dac/gender-development/Minimum-recommended-criteria-for-DAC-gender-marker.pdf>
- Misioni i OSBE-së në Kosovë, Hulumtimi mbi mirëqenien dhe sigurinë e grave në Kosovë, <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/439781?doëload=true>
- Pande, Malhotra dhe Grown, "Ndikimi i Investimeve në Edukimin e Grave për Barazinë Gjinore, dokumenti i përgatitur për prezantim në Sesionin 3: Shkollimi, Konferenca Ndërkombëtare e Popullsisë XXV IUSSP, Ture, Francë, 2009, në: www.demoscope.ru/ëeekly/knigi/tours_2005/papers/iussp2005s51014.pdf
- Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat, Gra të forta dhe me vizion - Gratë rurale në Kosovë krijojnë vende pune dhe jetesë më të mirë, 2019, në: <https://ppse-kosovo.org/women-of-resilience-and-vision-rural-ëomen-in-kosovo-creating-jobs-and-better-lives-/>

- Programi i të Drejtave Pronësore (PRP), Studimi bazë në nivelin nacional mbi të drejtat pronësore në Kosovë, 2015, në: <https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1863/1.%20National%20Baseline%20Survey%20for%20Property%20Rights%20in%20Kosovo.pdf>
- Qosaj-Mustafa dhe Morina, "Qasja në drejtësi për viktimat e dhunës me bazë gjinore: Përfundimi i mosndëshkimit të autorëve të krimit, 2018, në: http://www.kipred.org/repository/docs/Accessing_Justice_for_Victims_of_Gender_Based_Violence_in_Kosovo_Ending_Impunity_for_Perpetrators_820425.pdf
- Rae L. Blumberg, "Paragjykimi gjinor në librat shkollorë: Një pengesë e fshehur në rrugën drejt barazisë gjinore në arsim, 2008, në: https://pdfs.semanticscholar.org/d193/38b08a8aa5c6c647e9582a78c77276387478.pdf?_ga=2.146834167.1163171261.1589284959-572287538.1589284959
- Shelley Correll, Gjinia dhe Procesi i Zgjedhjes së Karrierës: Roli i Vetë-vlerësimeve, 2001, Chicago Journals, në: https://sociology.stanford.edu/sites/g/files/sbiybj9501/f/publications/gender_and_the_career_choice_process-_the_role_of_biased_self-assessments.pdf
- Zyra e OKB-së e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Dhunës ndaj Grave, Neni 10, 1981
- Victor Lavy, A i zvogëlojnë stereotipet gjinore arritjet e kapitalit njerëzor të vajzave apo djemve? Dëshmi nga një eksperiment natyror, Revista e Ekonomisë Publike, 2008,

Më shumë informacione

www.coe.int/education

Kontakt

Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë
Rruga 17/18 Bedri Pejani
10000 Prishtinë

Email: coe.pristina@coe.int

Tel: 383 (0) 38 407 750

Fax: +383 (0) 38 407 751

ALB

Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku njohuritë, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm ndërsa ruajnë kulturën diversitetin, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i përkushtuar të ndajë arritjet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të tij.

www.europa.eu

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e të drejtave të njeriut në kontinent. Ai përfshin 47 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë vendet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, një traktat i krijuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës në vendet anëtare.

www.coe.int

